



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2021:054539

Datë: 22.12.2021

Numri i dokumentit: 02544152

PPP.nr.14/2021

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG, si përmbarimore, me gjyqtarin individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike të kreditorit: AFK (Agjencioni për Financim në Kosovë) me nr fiskal Rr. Lidhja e Prizrenit nr.1 Pejë, kundër debitorëve: Rr. A. me nr personal, me adresë në Fsh. L. Komuna e Istogut (kredi marrës), A. A. me nr personal, me adresë në Fsh. L. Komuna e Istogut (bashkë kredi marrës), për shkak të borxhit në shumë prej 2,009.93€, pas prapësimit të ushtruar nga debitori i parë me dt: 03.02.2021 kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, gjykata jashtë seance me dt.22.12.2021 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit: Rr. A. me nr personal, me adresë në Fsh. L. Komuna e Istogut (kredimarrës), ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarim P.nr.79/2021 të dt.18.02.2021, sipas propozimit të kreditorit AFK (Agjencioni për Financim në Kosovë) me nr fiskal Rr. Lidhja e Prizrenit nr.1 Pejë.

A r s y e t i m

Kreditori AFK (Agjencioni për Financim në Kosovë) me nr fiskal Rr. Lidhja e Prizrenit nr.1 Pejë, ka ushtruar propozimin për përmbarim te përmbaruesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përmbarimi ndaj debitorëve: Rr. A. me nr personal, me adresë në Fsh. L. Komuna e Istogut (kredi marrës), A. A. me nr personal, me adresë në Fsh. L. Komuna e Istogut (bashkë kredi marrës), si në shkresat e lëndës me të cilën do të paguajnë borxhin në shumë prej 2,009.93€, €, të gjitha këto ne afat 7 ditor nga dita e pranimit te

urdhrit, ne të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarive bankare që të realizoj kërkesën e tij ndaj debitorit, të gjitha këto te specifikuar ne propozimin për përmbarim te dt. 18.02.2021.

Përmbaruesi privat me urdhrin përmbarimit P.nr.79/2021 të dt.18.02.02021 e ka lejuar propozimin për përmbarim në këtë çështje përmbarimore.

Debitori i parë Rr. A. me nr personal, me adresë në Fsh. L. Komuna e Istogut (kredi marrës), brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me shkrim kundër urdhrin përmbarimor, duke e kontestuar urdhrin përmbarimor me arsyetimin se duhet te shtyhet përmbarimi sepse do ti shkaktoj dëme te riparueshme debitorit konform nenit 61 par.4 dhe e bazë te nenin 116 te LMD-së.

Me tutje debitori shton se me kreditorin kam lidhur kontratë mbi huan, por pas lidhje se te njëjtës gjendja është keqësuar si pasoj e pagesës një kredie tjetër andaj kërkon shtyrjen, pasi ne gjendjen aktuale nuk mund ti përmbush detyrimet, ndërsa veturën qe kreditori e ka paraqitur si objekt përmbarimi është ne përdorim te vazhdueshëm dhe nga e njëjta debitori është i varur për te shkuar ne punë, e për te cilën punën e mban familjen.

Pas prapësimit të ngritur nga debitori, kreditori ka paraqitur përgjigjeje në prapësim duke theksuar se të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar dhe si i pa afatshëm. Debitori nuk ka paraqitur prova se ku e mbështetë prapësimin e tij, ku i njëjti është në vonës në bazë të nenit 305.1 të LMD-së, debitori është në vonesë kur nuk e përmbush detyrimin brenda afatit të caktuar për përmbushje. Andaj i propozojmë Gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit si të pa bazuar dhe të vërtetojë urdhrin për lejimin e përmbarimit.

Gjykata Themelore në Pejë – Dega Istog, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe thëniet e cekura në të njëjtin dhe gjeti se i njëjti është i pa bazë. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit nuk tregojnë shkaqet sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohet përmbarimi i lejuar nga përmbaruesi privat.

Gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës, si dhe sa i përket pretendimeve të debitorit të parë në prapësim duke e kontestuar urdhrin përmbarimor dhe duke kërkuar shtyrjen e ekzekutimit, lidhur me pretendimet e lartcekura gjykata sqaron faktin se me datë 25.04.2018, ndërmjet kreditorit dhe debitorëve është lidhur marrëveshja mbi kredinë si dhe marrëveshjen kolaterale vazhduese me afat kthimi prej 36 muajve, ku nenin 4 të Kontratës së lartcekur është paraparë kthimi i kredisë, kurse në nenet 7, 8 dhe 9 të së njëjtës kontratë janë paraparë detyrimet e përgjithshme të kredi marrësit, mos përmbushja e marrëveshjes nga ana e kredi marrësit dhe të drejtat e kreditorit për kompensimin nga ana e kredi marrësit dhe bashkë kredi marrësit nëse nuk respektohen ndonjëri nga nenet e kësaj marrëveshje, kreditorit i është dhënë e drejta të ndërmarrë veprimeve ligjore kundër kredi marrësit për mbrojtjen e drejtave të veta, andaj me rastin e lidhjes se marrëveshjes me datë 25.04.2018, kanë lindur te drejta dhe obligime ne mes palëve kontraktuese, të cilat kanë

qenë të obliguara të dy palët ti respektojnë, ku kredi dhënësi i ka lëshuar kredinë, ndërsa kredi marrësi ka qenë i obliguar kthimin e kredisë në një periudhën kohore prej 36 muajve, dhe në rast të mos respektimit të kushteve të kontratës secila nga palët ka pasur të drejtë që të inicioj procedurë gjyqësore për mos zbatim të dispozitave kontraktuese, e në rastin konkret debitorët kur nuk ka bërë pagesat sipas marrëveshjes, atëherë janë shkelur nenet e kontratës dhe janë shkaktuar pasoja juridike në dëm të kreditorit.

E në rastin konkret debitori si shkelës të kontratës ka obligim pagesën të cilën e kërkon kreditori në këtë çështje juridike-përmbare, e duke u bazuar në nenin 245 par.1 të LMD-së i cili nën parasheh se “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, ndërsa par.2 i po të njëjtit nën parasheh se “Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak”.

Po ashtu neni 249 par.1 të LMD-së parasheh se “Kreditori ka të drejtë në shpërblim të dëmit të thjeshtë dhe të fitimit të humbur, të cilat debitori është dashur t'i parashikonte detyrimisht në kohën e lidhjes së kontratës, si pasoja të mundshme të shkeljes së kontratës e duke marrë parasysh faktet të cilat i ka pasur të njohura ose është dashur detyrimisht t'i kishte të njohura”, ndërsa par.2 i po të njëjtit nën parasheh se “Në rast mashtrimi ose të mos përmbushjes me dashje, si dhe të mos përmbushjes për shkak të pakujdesisë së rëndë, kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitorët shpërblimin e të tërë dëmit, i cili është shkaktuar për shkak të shkeljes së kontratës, pa marrë parasysh atë se kreditori nuk ka ditur për rrethana të veçanta, për shkak të cilave janë shkaktuar ato”.

Lidhur me kërkesën e kreditorit për shtyrje të ekzekutimit, gjykata duke u bazuar në nenin 61 par.4 parasheh se “Organi përmbare mund plotësisht ose pjesërisht ta shtyjë përmbaremin në situata ku debitori dëshmon përmes dokumenteve publike ose të vërtetuara se përmbaremi do t'i shkaktojë dëm të pariparueshëm dhe jep si garanci shumë e cila së paku korrespondon me shumën e kërkesës”, andaj i njëjti nuk ka ofruar prova që e dëshmon gjendjen e vështirë e po ashtu nuk ka dhen asnjë lloj garancie që do ta përmbushte obligimin nëse shtyhet i njëjti, kurse fakti se është duke u zhvilluar një procedurë tjetër nuk jep bazë për shtyrje të ekzekutimit.

Gjykata, duke u bazuar në nenin 17 të LPP-së, përshtatshëmish aplikoj dispozitat ligjore të LMD-së.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, e konform dispozitave të nenit 3, 17, 22 par. 1.9, 38, 61, 69, 71, 73 par. 3 të Ligjit të Procedurës Përmbare, e në lidhje me nenin 245 par.1 dhe 2, 249 par. 1 dhe 2, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e në lidhje me Marrëveshjen mbi kredinë të dt. 25.04.2018, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG
PPP.nr.14/2021 dt: 22.12.2021

GJYQTARI
Blerim Istrefi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.